KANTON
LUZERN

Gesundheits- und Sozialdepartement
Dienststelle Gesundheit und Sport

Sorgen Sie vor!

Programi për parandalimin e kancerit të zorrës së trashë në Kantonin Luzern

Pse janë të rëndësishme masat parandaluese?

Kanceri i zorrës së trashë është një nga llojet më të shpeshta të kancereve në Zvicër. Në zorrën e trashë mund të krijohen ënjtje të vogla. Këto quhen polipe. Shumë polipe nuk janë të rrezikshme për shëndetin. Vetëm pak prej tyre shndërrohen dalëngadalë në kancer. Këto dallohen vetëm kur sëmundja ka përparuar ndjeshëm. Prandaj është e rëndësishme: Sa më herët të dallohet ndonjë anomali në zorrë, aq më të mëdha janë shanset e shërimit.

Pas moshës 50-vjeçare shtohet rreziku i shfaqjes së sëmundjes. Prandaj Kantoni Luzern i fton të gjithë personat mes moshës 50 dhe 74 vjeç që të marrin pjesë në programin e parandalimit të kancerit të zorrës së trashë.
Pjesëmarrja në program është në mënyrë vullnetare.
Masat parandaluese të rregullta mund të kursejnë shumë vuajtje. Më pak njerëz sëmuren nga kanceri i zorrës së trashë.

Metodat e ekzaminimit

Ju keni dy mundësi për të bërë një ekzaminim si masë parandaluese. Për këtë mund të këshilloheni me mjeken ose mjekun tuaj si dhe në farmaci:

Testi i gjakut në feçe
(Shkurtimi FIT)
Kontroll për gjak të padukshëm në feçe

Kanceri i zorrës së trashë shpesh shkakton pak gjakderdhje. Por ky gjak në feçe nuk shihet dot. Prandaj bëhet testi FIT. Me anë të tij mund të maten shumë thjesht gjurmët e gjakut në feçe.

Kolonoskopi
Kontroll i brendshëm i zorrës

Kolonoskopia bëhet nga mjeku specialist. Ky fut në zorrë një tub me një kamera të vogël. Në këtë mënyrë mjeku mund ta kontrollojë zorrën përbrenda.

Kostot

Sigurimi shëndetësor mbulon koston e ekzaminimit, nëse ky bëhet në kuadër të programit parandalues të Kantonit Luzern. Sigurimi shëndetësor ju faturon vetëm kontributin tuaj vetjak prej 10 përqind. Për testin e gjakut në feçe, kjo shumë është rreth 5 franka. Kolonoskopia ju kushton mes 50 dhe 150 franka, në varësi nëse ka polipe që duhet të hiqen. Këtu shtohen sipas rastit edhe kostot e një këshillimi mjekësor paraprak dhe kostot për ilaçet për zbrazjen e zorrës para kolonoskopisë.

Procedura e ekzaminimit

Këtu shihni hap pas hapi si kryhet ekzaminimi.

Testi i gjakut në feçe

(Shkurtimi FIT)

Kontroll për gjak të padukshëm në feçe

Kolonoskopi

Kontroll i brendshëm i zorrës

Regjistrimi

Regjistrimi është i mundur:
- Internet: www.darmkrebsvorsorge.lu.ch
- Mjekja / mjeku ose farmaci - shih listën www.darmkrebsvorsorge.lu.ch/ Partnerw tw akreditуar

Do të pajiseni me një numër personal, numrin e referencës.

Regjistrimi tek të akreditуar:
- Mjekja / mjeku i shtëpisë
- Gjinekologia / Gjinekologu

Do t'ju këshillojnë, do t'ju japin një numër reference. Zyra e mjekut do t'ju regjistrojë për një kolonoskopi te një mjeke ose mjek specialist.

Testi / Ekzaminimi

- Porositni testin me numrin e referencës
- Posta jua sjell testin në shtëpi
- Lexoni udhëzimin, bëni kampionin e feçes
- Dërgojeni mbrapsht kampionin
- Rezultati i testit ju vjen me postë në shtëpi

S'ka gjak – rezultati negativ:
Pas dy vitesh ju dërgohet automatikisht një test i ri në shtëpi.

Gjak – rezultati pozitiv:
Kontaktoni zyrën e mjekut tuaj të shtëpisë.

Është e rëndësishme, që para ekzaminimit ta përgatitni zorrën si duhet.
- Dietë sipas udhëzimeve të mjekes / mjekut
- Pirja e lëngut për pastrimin e zorrës
- Ekzaminimi në zyrën e mjekut

S'ka anomali:
Ekzaminimi i radhës bëhet pas dhjetë vitesh. Do t'jua kujtojnë me shkrim.

Anomali:
Mjekja / mjeku juaj do të flasë me ju për ecurinë e mëtejshme.

Informacione të mëtejshme

Informacione të mëtejshme në gjuhë të ndryshme i gjeni tek faqja e programit **www.darmkrebsvorsorge.lu.ch**. Nëse keni pyetje mund të kontaktoni qendrën e programit me telefon tek **041 228 70 00** ose me e-mail tek **darmkrebsvorsorge@lu.ch**.

Kujdesuni për shëndetin tuaj – merrni pjesë në programin e parandalimit.